



MINISTRIA E EKONOMISË  
KULTURES DHE INOVACIONIT  
Nr. 3360 Prot.  
Dati, më 27.2.2025

REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 120, datë 26.2.2025

PËR

**DEKLARIMIN PASURI KULTURORE E PALUAJTHSHME “QENDËR HISTORIKE” TË NJË ZONE NË FSHATIN RABDISHT, PESHKOPI, PËRCAKTIMIN E ZONËS MBROJTËSE DHE MIRATIMIN E PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “a” e “ç”, të pikës 3, të nenit 9, të nënndarjes “iii”, të shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 53, të pikës 3, të nenit 62, dhe të pikës 1, të nenit 96, të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme “Qendër historike” të një zone në fshatin Rabdisht, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Përcaktimin e zonës mbrojtëse të “Qendrës historike” të një zone në fshatin Rabdisht, sipas koordinatave dhe hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
3. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e këtyre zonave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për publikimin e hartave të “Qendrës historike” të fshatit Rabdisht dhe zonës mbrojtëse në Gjeoportalin Kombëtar.

5. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Dibër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

## K R Y E M I N I S T R I

### EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi  
ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
*[Signature]*  
BELINDA BALLUKU

MINISTRI I EKONOMISË,  
KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHA

## **PLANI**

### **PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMINE QENDRËS HISTORIKE DHE ZONËS MBROJTËSE TË FSHATIT RABDISHT**

#### **Neni 1 Qëllimi dhe objektivat**

Ky plan përcakton rrugët, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e “Qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse të saj në fshatin Rabdisht, si dhe kufijtë e tyre.

#### **Neni 2 Objekti**

Objekt i këtij plani është:

1. administrimi i “Qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse të fshatit Rabdisht, sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet këtij plani, si pjesë integrale e tij.
2. mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore dhe vlerave të peizazhit të “Qendrës historike” të fshatit Rabdisht.
3. mënyra e bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore për ruajtjen, mbrojtjen, administrimin dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore e të peizazhit të “Qendrës historike” të fshatit Rabdisht.

#### **Neni 3 Hapësira urbane në mbrojtje**

1. Hapësira urbane në mbrojtje e fshatit Rabdisht përbëhet nga:
  - a) qendra historike;
  - b) zona mbrojtëse.
2. Brenda këtyre zonave të përcaktuara në pikën 1, të këtij nenit, përfshihen ansamble arkitektonike-urbane, objekte shoqërore, banesa tradicionale të lidhura ngushtë me peizazhin urbanistiko-arkitektonik, historik, tradicional, zona të gjelbra, sheshe dhe një rrjet rrugor me kalldrëm në pjesën dominuese të tij.
3. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Dibër duhet të marrë parasysh kufijtë

dhe kriteret e mbrojtjes së "Qendrës historike" dhe zonës mbrojtëse të saj.

4. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e "Qendrës historike" dhe zonës mbrojtëse përreth saj.

#### **Neni 4** **Qendra historike dhe kufijtë e saj**

1. "Qendra historike" e fshatit Rabdisht është hapësira urbane me vlera të rëndësishme urbanistiko-arkitekturore, që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të fshatit dhe arritjet në arkitekturë e në urbanistikë. Koordinatat në sistemin referues zyrtar në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH) të "Qendrës historike" paraqiten në aneksin 1, që është pjesë përbërëse e këtij plani.
2. Kufijtë e "Qendrës historike" paraqiten në hartën e zonifikimit të fshatit Rabdisht, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

#### **Neni 5** **Zona mbrojtëse e "Qendrës historike" dhe kufijtë e saj**

1. Zona mbrojtëse ruan vlera historiko-kulturore, me të cilat plotëson e pasuron vlerat e qendrës historike dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt pjesëve të lira të fshatit.
2. Kufijtë e zonës mbrojtëse paraqiten në hartën e zonifikimit të fshatit Rabdisht, e cila është pjesë përbërëse e pandarë e këtij plani. Koordinatat në sistemin referues zyrtar në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH) të zonës mbrojtëse paraqiten në aneksin 2, që është pjesë përbërëse e këtij plani.

#### **Neni 6** **Ndërhyrjet e lejuara në "Qendrën historike"**

1. Ndërhyrjet në "Qendrën historike" kanë si qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, historike, urbanistike, arkitektonike të fshatit Rabdisht.
2. Në "Qendrën historike" nuk lejohen ndërtimet e reja.
3. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të "Qendrës historike", brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

- a) Ndërhyrje sistematike mirëmbajtëse, konservuese, restauruese dhe rrijetëzuese, sipas parimeve të konservimit të integruar;
- b) Ndërhyrjet restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, si dhe duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese e të bimësisë tradicionale;
- c) Ritractimi dhe rikonstruksioni pjesor, ku të ruhet maksimalisht objekti ekzistues, duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit apo të zonës, duke respektuar kompozimet e trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimive karakteristike dhe ndërtimet e vëna në mbrojtje, duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre (2 kate). Këto ndërhyrje shoqërohen me studime arkitektoniko-urbanistike për evidentimin e vlerave të trashëgimisë kulturore brenda zonës;
- ç) Çatitë duhet të janë katër ujëse, të kenë pjerrësi 25-30 gradë dhe të mbulohen me plloça guri. Mbulesat e tjera, si llamarinë, pllaka të ndryshme, si dhe tjegulla janë të ndaluara;
- d) Në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni/rindërtimi mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozisional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.;
- dh) Ndalojen ndërtimet e reja në “Qendrën historike”, me përjashtim të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve, të përmendura në pikat më sipër.

### **Neni 7 Ndërhyrjet e lejuara në zonën mbrojtëse të “Qendrës historike”**

1. Në këtë zonë kryhen:

- a) ndërhyrje sistematike restauruese, konservuese dhe të mirëmbajtjes, përshtatje, rikonstruksione e ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të janë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit;
- b) rrijetëzime, me kusht që projekti i rrijetëzimit të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar;
- c) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr.27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar.

2. Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve, përvèç rasteve kur për to ka studime të veçanta, nuk duhet t'i kalojë 3 (tre) katet dhe lartësinë 10 (dhjetë) m deri në kornizën e çatisë.
3. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfollogjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave, etj.
4. Çatitë duhet të jenë katër ujëse, të kenë pjerrësi 25-30 gradë dhe të mbulohen me plloça guri ose tjegulla vendi ngjyrë gri. Mbulesat e tjera, si llamarinë, pllaka të ndryshme, si dhe tjegulla me ngjyrë tjetër janë të ndaluara.
5. Rrjeti rrugor ruhet në kompozimin teknikë dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik.
6. Lejohet rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe shesheve për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës apo për përmirësimin ose realizimin e linjave të reja të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, duke përdorur materiale, forma dhe teknika tradicionale.
7. Lejohen ndërhyrje të mobilimit urban, me vendosje mbi rrugë të stolave, ndriçuesve, koshave, vazove me lule ose elementeve të tjera të mobilimit urban, me kusht që të jenë pjesë e një projekti rikualifikimi të zonës, që parashikon vendosjen e elementeve, në harmoni me tipologjinë dhe vlerat tradicionale.
8. Lejohen ndërhyrje për modifikimin e gjurmës rrugore, e lidhur me nevojat përfunksionim dhe përdorim sa më të mirë të zonës, brenda së cilës rruga ndodhet.
9. Në rastet kur gjurma e rrugës në të cilën ndërhyhet shtrihet në disa zona, ndërhyrja i nënshtrohet kritereve të zonës me mbrojtje më të lartë.

**Neni 8**  
**Ndërhyrjet e ndaluara në tërësinë e “Qendrës historike” dhe zonës mbrojtëse të saj**

1. Ndalojen ndërtimet e reja në “Qendrën historike”, me përjashtim të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura në pikat më sipër.
2. Në zonën mbrojtëse të “Qendrës historike” nuk lejohen ndërtimet me karakter industrial, me përjashtim të punishteve të artizanatit.
3. Ndërtimet pa leje, të ndodhura brenda territorit të “Qendrës historike” dhe

zonës mbrojtëse të saj, trajtohen në përputhje me ligjin nr.20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Shprehja e autoritetave të trashëgimisë kulturore është kusht për përfundimin e procedurave të legalizimit për të gjitha rastet e specifikuara shprehimisht në ligj.

### Neni 9

#### **Objektet pa status, pjesë e ansambleve arkitektonike të “Qendrës historike”**

Objektet pa status, pjesë e ansambleve arkitektonike të “Qendrës historike”, janë objekte të ndërtuara në vitet ‘50-‘90 brenda qendrës historike, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor, nuk janë në harmoni me unitetin kompozicional të këtyre ansambleve.

### Neni 10

#### **Kriteret e projektimit për ndërhyrjet e lejuara në “Qendrën historike”, monumentet e kulturës dhe zonën mbrojtëse**

1. Studimet arkitektoniko-urbanistike për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të “Qendrës historike” të zonës mbrojtëse të saj, të cilat përcaktojnë objektet ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, ritrajtime, rikonstruksione dhe rindërtime hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim IKTK), drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore (në vijim DRTK), përgjegjëse për Peshkopinë, ose persona fizikë apo juridikë, të licensuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe shqyrtohen e miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim KTKM).
2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin e objekteve në “Qendrën historike” hartohen në varësi të vlerave historike-kulturore të objektit, si dhe në kriteret për konservim dhe restaurim, bazuar në kartat ndërkombëtare për restaurim, legjisacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Këto projekte hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose persona fizikë apo juridikë, të licensuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe shqyrtohen e miratohen në KTKM.
3. Projektet për rikonstrukcionin/rindërtimin/ritrajtimin/rijetëzimin e objekteve ekzistuese brenda “Qendrës historike” hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose persona fizikë apo juridikë, të licensuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, bazuar në studimet urbanistike dhe arkitektonike:

- a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të ndërtesave të zonës, elementet origjinale të dukshme, të jashtme e të brendshme, tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik e grafik;
  - b) duke respektuar kushtet zhvillimore e vëllimore, trajtimin arkitekturor dhe elementet arkitektonike;
  - c) duke ruajtur sa më shumë trajimin origjinal të pamjeve të jashtme, duke respektuar volumin ekzistues, ndërsa brendësia e tyre mund të ndryshojë, duke respektuar elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore;
  - ç) duke respektuar kushtin që lartësia nuk duhet të kalojë lartësinë e dy-tri kateve;
  - d) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dyerve dhe dritareve, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës;
  - dh) duket ruajtur originalitetin e ndërtimit të çative, në rastet e mbulesave me çati, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës.
4. Projektet për rikonstrukcionin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimet e reja, brenda zonës mbrojtëse të "Qendrës historike", hartohen bazuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Peshkopi apo studimeve urbanistike e arkitektonike, nga persona fizikë apo juridikë, të licensuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale.
5. Projektet për rikonstrukcionin e ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore brenda zonës mbrojtëse të "Qendrës historike" hartohen:
- a) bazuar parashikimeve të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Peshkopi;
  - b) duke mos cenuar vlerat e objekteve ekzistuese në mbrojtje;
  - c) duke mos krijuar kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik.

### Neni 11

#### **Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në "Qendrën historike" dhe zonës mbrojtëse**


1. Studimet arkitektoniko-urbanistike, të cilat hartohen për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të "Qendrës historike" dhe të cilat përcaktojnë objektet ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, ritrajtime, rikonstruksione, rindërtime dhe rehabilitimi, hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licensuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale dhe miratohen në KTKM.

2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin e rrijetëzimin në "Qendrën historike" hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licensuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KTKM. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë ose subjekte të licensuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.
3. Projektet për rikonstruksionin/rindërtimin/ritrajtimin e objekteve ekzistuese brenda "Qendrës historike" hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licensuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja ose subjekte të licensuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.
4. Projektet për rikonstruksionet, ndërhyrje integruese, përshtatjet në sheshe të lira dhe ndërtimet e reja në zonën mbrojtëse të "Qendrës historike" hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja, përgjegjëse për Peshkopinë, ose nga persona të licensuar për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KTKM. Procedura e miratimit vijon sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit dhe ndërtimeve të reja kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori. Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet nga subjekte të licensuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë.
5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore në zonën mbrojtëse hartohen nga persona, të licensuar sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet sipas ligjit për planifikimit dhe zhvillimit të territorit. DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë monitoron procesin e zbatimit të punimeve.
6. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimin e flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në "Qendrën historike" hartohen nga persona fizikë apo juridikë, të licensuar për projektim të

veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen edhe në KTKM. Procedura më pas vijon me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Mbikëqyrja e punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse për Peshkopinë.

### **Neni 12** **Dispozita të fundit**

Shtesat dhe ndryshimet në këtë plan bëhen me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.



## LEGJENDË

- Qendra Historike, Rabdisht
- Zona e Mbrojtur e Qendrës Historike

**ANEKSI I: KOORDINATAT E “QENDRES HISTORIKE” TË NJË ZONE  
NË FSHATIN RABDISHT**

1.	541084.9	4616802
2.	541098.9	4616799
3.	541120.3	4616792
4.	541134.9	4616786
5.	541146.6	4616786
6.	541154.9	4616785
7.	541158.6	4616784
8.	541163.6	4616781
9.	541168.6	4616774
10.	541171.1	4616772
11.	541249.9	4616785
12.	541267.2	4616764
13.	541280.2	4616772
14.	541286.8	4616766
15.	541311.7	4616762
16.	541328.7	4616761
17.	541336.1	4616762
18.	541343	4616763
19.	541345.6	4616763
20.	541366.3	4616773
21.	541370.9	4616774
22.	541375.4	4616774
23.	541379.6	4616775
24.	541382.5	4616776
25.	541387.4	4616776
26.	541411.6	4616800
27.	541425	4616800
28.	541465.5	4616787
29.	541476	4616716
30.	541474.6	4616710
31.	541473.2	4616705
32.	541471.1	4616702
33.	541438	4616713
34.	541421.5	4616716
35.	541398.6	4616716
36.	541384.3	4616712
37.	541364.1	4616708
38.	541350.9	4616700
39.	541338.8	4616672
40.	541335.6	4616666

41.	541326.4	4616651
42.	541313.6	4616631
43.	541284.2	4616644
44.	541270.9	4616609
45.	541248.6	4616615
46.	541239.9	4616622
47.	541213.1	4616635
48.	541209.9	4616631
49.	541184.9	4616637
50.	541181.8	4616682
51.	541183.2	4616685
52.	541180	4616698
53.	541173.9	4616695
54.	541162.8	4616716
55.	541158.2	4616722
56.	541144.7	4616713
57.	541142.1	4616714
58.	541130.3	4616728
59.	541126	4616737
60.	541116.5	4616737
61.	541110.5	4616736
62.	541102.2	4616762
63.	541090.3	4616763
64.	541084.8	4616802
65.	541084.9	4616802
66.	541084.9	4616802

**ANEKSI II: ZONA MBROJTESE E “QENDRES HISTORIKE” TË NJË  
ZONE NË FSHATIN RABDISHT**

1.	540976.922	4616786
2.	540988.325	4616766.3
3.	540997.347	4616790.62
4.	541023.04	4616749.7
5.	541030.762	4616791.2
6.	541043.465	4616703.44
7.	541048.228	4616713.04
8.	541051.638	4616847.01
9.	541051.638	4616847.01
10.	541069.735	4616661.65
11.	541089.889	4616838.78
12.	541105.316	4616650.47
13.	541114.843	4616626.58
14.	541125.253	4616840.37
15.	541154.754	4616608.75
16.	541157.153	4616840.22
17.	541177.849	4616539.32
18.	541184.867	4616848.16
19.	541195.26	4616854.8
20.	541205.075	4616855.81
21.	541219.78	4616555.27
22.	541236.957	4616569.78
23.	541248.09	4616876.16
24.	541259.782	4616888.29
25.	541281.74	4616896.46
26.	541292.241	4616584.28
27.	541315.083	4616918.69
28.	541326.486	4616929.95
29.	541337.024	4616933.99
30.	541357.087	4616911.04
31.	541360.588	4616574.47
32.	541367.011	4616623.47
33.	541372.821	4616892.28
34.	541461.556	4616604.24
35.	541464.515	4616929.01
36.	541531.13	4616670.56
37.	541535.532	4616723.61
38.	541538.419	4616671.72
39.	541543.182	4616677.78
40.	541546.647	4616916.38

41.	541552.637	4616796.43
42.	541553.936	4616681.17
43.	541560.648	4616689.69
44.	541561.586	4616864.85
45.	541572.196	4616847.39
46.	541578.98	4616751.69
47.	540976.922	4616786

NR.PROT.1131/1  
DATË 26.2.2025

MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE  
INOVACIONIT  
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS  
BASHKISË DIBËR  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

**Në mungesë dhe me porosi**

**Herald JONUZAJ**

